



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0285

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Avni Murtezi B.I.” kundër Vendimin për dhënien e një kontrate të Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023 2024” me nr. Të prokurimit: “623-23-13234-1-2-1” me 19/06/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Avni Murtezi B.I.” me nr. 2024/285 , e datës 02.04.2024 lidhur me aktivitetin e “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023 2024” me nr. Të prokurimit: “623-23-13234-1-2-1” iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)- Komuna e Rahovecit.

2.Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Rahovecit lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.11.2023 Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023 2024” me nr. të prokurimit: “623-23-13234-1-2-1” Ndërsa me datë 21.03.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate “N.T.P Harris”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 124,640.00 €.

Me 26.03.2024 OE “Avni Murtezi B.I.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga “Avni Murtezi B.I.” me nr. 285/2024 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023 2024” me nr. Të prokurimit: “623-23-13234-1-2-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Avni Murtezi B.I.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “Kronologjia e aktivitetit të prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024” AK dhe Zyrtari përgjegjës i Prokurimit nuk e kanë zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së të datës 13.03.2024, sepse procesi i rivlerësimit është bërë duke shkelur LPP, legjislacionin sekondar dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Për më tepër rivlerësimi i ofertave është bërë vetëm sa për të thënë se është bërë dhe ne do t’i shpalosim faktet në vijim të kësaj kërkesë. Shihet qartë se tendenca e ZPP dhe AK ka qenë që OE N.P.T “HARIS” të favorizohet edhe në këtë aktivitet të prokurimit siç ka ndodhë për vite me radhë, fakt ky që mund të shihet nga lista e kontratave të dorëzuar, ku shihet se OE N.P.T “HARIS” në tri vitet e fundit është nënshkruar i kontratës me AK K.Rahovec. Pra OE N.P.T “HARIS” ka krijuar monoplo në këtë aktivitet të prokurimit në K.Rahovecit duke e dëmtuar buxhetin e Komunës nga nënshkrimi i kontratave me çmim më të lartë. ZPP dhe Komisioni i vlerësimit ka në bërë shkelje të LPP dhe legjislacionit sekondar përsëri gjatë procesit të rivlerësimit, duke i injoruar OE të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët dhe duke e shpërblyer me kontratë OE N.P.T “HARIS” në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024”. Faktet tona se ZPP dhe Komisioni i vlerësimit kanë shkelur LPP dhe legjislacionin

sekondar duke zhvilluar një proces të vlerësimit të ofertave që diskriminon dhe e trajton në mënyrë jo të barabartë OE N.T.Sh. “Berveniku” mund të shihen në kopjen e letrës standarde për tenderuesin e eliminuar që e kemi pranuar në vlerësimin për herën e parë dhe herën e dytë. Duke i krahasuar këto dy letra standarde për eliminimin e OE N.T.Sh. “Berveniku” vërehen qartë tendencat diskriminuese e ZPP dhe Komisionit të vlerësimit dhe qëndrimi jo konsistent për zbatimin e kërkesave të dosjes së tenderit të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024”. Ne ankese gjeni arsyet e eliminimit të OE N.T.Sh. “Berveniku” për herën e parë sipas ZPP dhe Komisionit të Vlerësimit. Ne kemi kundërshtuar këtë vlerësim jo të drejtë, të pabazuar dhe diskriminues të ZPP dhe Komisionit të vlerësimit në K.Rahovecit ndaj OE N.T.SH. “Berveniku” duke ofruar dëshmi të dokumentuar se i kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe se pretendimet e ZPP dhe Komisionit për vlerësim nuk janë të vërteta, me parashtrimin e kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues dhe paneli i OSHP-së i kanë konfirmuar shkeljet tona të paraqitura në ankesë dhe me Vendimin e OSHP-së Nr. 2024/0030, lënda është kthyer në rivlerësim. Në procesin e rivlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024” ZPP dhe Komisioni i vlerësimit kanë bërë shkelje të përsëritura të LPP dhe legjislacionit sekondar duke e diskriminuar përsëri OE N.T.SH. “Berveniku” dhe duke e favorizuar OE N.P.T “HARIS”. Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, për OE N.T.SH. “BERVENIKU”, arsyet e eliminimit në proces të ri-vlerësimit (vlerësimi për herën e dytë) janë ndryshuar nga arsyet e eliminimit në proces të vlerësimit (vlerësimi për herën e parë)! Arsyet e eliminimit të OE. N.T.Sh. “Berveniku” gjatë procesit të rivlerësimit nuk qëndrojnë dhe janë të orkestruara me qëllim të diskriminimit të OE. N.T.Sh. “Berveniku” dhe favorizimit të OE N.P.T “HARIS”. Qëndrimi jo konsistent dhe i njëanshëm i ZPP dhe Komisionit të vlerësimit në zbatimin e kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024” janë jashtëzakonisht shqetësuese se sa ZPP dhe komisioni i vlerësimit i zbatojnë përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me LPP dhe legjislacionin sekondar. Kjo përbën bazë që ndaj këtyre zyrtarëve të ndërmerren masa për shkelje ligjore siç parashihet me RRPP. Në proces të rivlerësimit të ofertave, arsyet e eliminimit për OE N.T.Sh. “Berveniku” të paraqitura në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar janë të bashkangjitura në ankesë. Ne e kemi dorëzuar listën e punëtoreve dhe nëse nënshkrimi i punëtoreve ka qenë fakt relevant për vlerësimi, ZPP dhe Komisioni i Vlerësimit kanë qenë të obliguar bazuar në nenin 10 të udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik që të kërkojnë sqarime. Mirëpo nuk kanë kërkuar sqarime nga OE N.T.Sh. Berveniku”. Arsyetja tjetër e eliminimit sipas ZPP dhe Komisionit të vlerësimit është e bashkangjitur në ankesë. Ne konsiderojmë që arsyetimet e ZPP dhe Komisionit për vlerësimin e ofertave për mospërputhjen e specifikacionit teknik të peletit të dorëzuar nga N.T.Sh. Berveniku nuk qëndrojnë. Po e dëshmojmë vetëm një fakt në fillim të fotografisë së mostrës që ne e kemi dorëzuar për pelet (thes) fotografia (e bashkangjitur në njoftimin mbi vendimin e AK) shkruan ISO 17225 2 sakte siç është kërkuar në dosjen e tenderit tek specifikacioni teknik. Po ashtu edhe të gjitha kërkesat të paraqitura në fotografinë e thesit me pelet që ne e kemi dorëzuar janë në harmoni me specifikacionin teknik të kërkuar në dosje. Sipas specifikacionit teknik të kërkuar në dosjen e tenderit është kërkuar që peleti në përbërje të jetë 70% ahu dhe 30% pishë. Ne kemi

ofruar plet me kualitet edhe me të lartë më përbërje 100% dru ah, çka do të thotë se ne e kemi plotësuar minimumin e kërkuar në specifikacionin teknik për përbërjen e peletit dhe jemi refuzuar sepse kemi ofruar pelet me cilësi më të lartë. Për më tepër siç mund të shihet nga Njoftimi mbi vendimin e AK dhe letrat standarde asnjëra nga mangësitë në specifikacionin teknik të N.T.SH. “Berveniku” që i ka cek ZPP nuk qëndrojnë. Për të mos i përshkruar një nga një, po e bashkangjesi fotografën e mostrës së dorëzuar (thesit) për pelet. 8/6 Në anan tjetër në formularin Njoftimi mbi vendimin e AK nuk është bashkangjitur fotografia e specifikacionit teknik të mostrës së dorëzuar (thesit me pelet) nga OE N.P.T “HARIS”. Pra edhe në njoftimin mbi vendimin e AK shihet tendenca e ZPP dhe Komisionit për vlerësim për ta favorizuar N.P.T “Haris”! Ne kemi kërkuar qasje në dokumente dhe e kemi marr ofertën e OE N.P.T “Haris” dhe kemi vërejtur se OE N.P.T “Haris” e ka nënshkruar specifikacionin teknik që është kërkuar në dosjen e tenderit ashtu siç e kemi nënshkruar dhe dorëzuar edhe ne, por nuk kemi gjetur dëshmi të fotografisë së mostrës së peletit (thesit me pelet). Prandaj, shihet qartë tendenca e ZPP dhe Komisionit për vlerësim që gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në mes të OE të veprohet në mënyrë diskriminuese dhe të favorizohet OE N.P.T “HARIS”. Bazuar në të gjitha këto, gjatë procesit të vlerësimit dhe rivlersimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024” ZPP dhe Komisioni i vlerësimit kanë shkelur dispozitat ligjore në vijim: - Është shkelur neni 1 Qëllimi i LPP-së i cili përcakton qartë që “Autoriteti kontraktues do t’i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Gjithashtu qëllimi i nenit 1 të LPP-së është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. - Është shkelur neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, i LPP-së – sepse komisioni i vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i kanë trajtuar njëtrajtshëm OE 9/6 pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024”. Pra OE N.T.Sh. “Berveniku” është diskriminuar duke mos e shpallur fitues edhe pse i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. - Është shkelur neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti – në bazë të cilit AK duhet të dëshmojë se procesi i prokurimit siguron vlerën për paratë për Autoritetin Kontraktues, ndërsa kontrata i është dhënë OE që është me çmim më të lartë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës, ndërsa krahasuar me OE N.T.Sh. “Berveniku” është më i shtrenjtë 13,612 euro. - Është shkelur neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, sipas të cilit të gjitha kontratat publike do të jepen përmes vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara dhe në përputhshmëri me kriteret për dhënien e kontratës. - Është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve sepse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara në dosje dhe dëshmime të ofruara nga OE N.T.Sh. “Berveniku” por është eliminuar pa arsye dhe kështu është kufizuar konkurrenca dhe është favorizuar OE i preferuar. - Është shkelur neni 60 kriteret për dhënien e kontratës sepse edhe pse në dosjen e tenderit është përcaktuar kriter për dhënien e kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, me kontratë i është dhënë OE N.P.T “Haris” i cili ka çmimin më të lartë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Avni Murtezi B.I.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60 të LPP-së si dhe Vendimi i OSHP-se 2024/0030, datë 13.03.2024. Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë që të nxjerrët: Vendim Aprovohet, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim OE N.T.Sh. “Berveniku” Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta. Përveç shkeljeve të paraqitura më lartë nga AK K. Rahovecit është vërejtur edhe një neglizhencë e qëllimshme në stërzgjatjen e këtij aktiviteti të prokurimit, për të vazhduar me procedurë të negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë më OE të preferuar nga ZPP. Në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023/2024” përveç që procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë nuk do të duhej të zbatohet bazuar në kufizimet ligjore për përdorimin e saj, përdorimi i saj e dëmton buxhetin e AK duke i shpenzuar paratë publike pa kritere dhe me çmime me të larta, si dhe OE Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë të njëjta.”

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: “Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimore nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e furnizimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve në atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të prezantuar, nuk keni dorëzuar Listën e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e furnizimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve në atë liste, ku dokumenti në fjale nuk mund të kërkojë në baze të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së 3 Kërkesa 4: Operatorët ekonomik bashkë me ofertë duhen të dorëzojnë mostrat për Një (1) thasë pelet me peshë ≤30 kg; Dëshmia 3: Mostrat e kërkuara tek specifikat teknike të mbyllura në një paketim dalluese të Operatorit

Ekonomik; Sqarimet janë si në vijim: Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë Mostrat e kërkuara tek specifikat teknike sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk janë në përputhje me Specifikat sipas Dosjes se tenderit.- Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1 Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr.1 nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues gjegjësisht Komisioni Ri-vlerësues ka vepruar konform dispozitave ligjore të përcaktuara me legjislacionin e Prokurimit Publik, dhe Ri-vlerësimi është bërë konform Ligjit për Prokurimin Publik ne Republikën dhe Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik; Ne si AK: Komuna e Rahovecit, e kemi respektuar plotësisht Vendimin e OSHP-së Nr. 2024/0030 duke e kthyer këtë aktiviteti të prokurimit në Ri-vlerësim dhe Komisioni Ri-Vlerësues ka vepruar konform dispozitave ligjore të përcaktuara me legjislacionin e Prokurimit Publik.- Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2 Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr.2 nuk qëndron. Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e furnizimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Ne te njëjta arsyeje ju kemi përshkruar dhe tek Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur: ku dokumenti ne fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së. - Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3 Pretendimi ankimor i parashtruar nga Operatori Ekonomik me Nr. 3 nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur: Mostrat e dorëzuara nga ana juaj nuk janë në përputhje me Specifikat teknike sipas Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Në vendimin për kërkesën për rishqyrtim janë te bashkangjitura Mostrat e dorëzuar nga ana juaj.Edhe pse ne pretendimin tuaj keni cekur se: mostrës që ne e kemi dorëzuar për pelet (thes) fotografia (e bashkangjitur në njoftimin mbi vendimin e AK) shkruan ISO 17225 2, Por përbërja e peletit duhet të jetë: Peleti të jetë 70 % dru ahë dhe 30% pishë Mostrat e dorëzuara nga ana juaj për pelet ne thasë .Ne baze te kësaj shihet qe Mostrat për pelet te dorëzuar nga ana juaj janë 100 % dru ahë. Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendim.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 08.04.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 285/2024, ndërsa me datë 19.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/285 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar, dhe te mbetet ne fuqi Vendimi i AK-së.

Lidhur me pretendimet e OE “Avni Murtezi B.I.” eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/285 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës : “Sqarim për PSH: AK-ja në këtë aktivitet të prokurimit sipas njoftimit për vendim e ka eliminuar OE ankues për mosplotësimin e kërkesave sipas dosjes se tenderit për kërkesën 1: Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e furnizimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Ndërsa arsyeja e dytë ka qenë specifikimi teknik nuk ka qenë në përputhje me aneksin 1 te dosjes së tenderit për pozicionet. Në kërkesën për rishqyrtim pretendimi i vetëm i OE ankues ka qenë për Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e kontratës, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit i cili pretendim është shqyrtuar në ankesën 2024/030. Vlen të theksohet se eksperti shqyrtues pajtohet me AK-në në pjesën e vlerësimit të OE ankues se nuk i ka plotësuar kërkesat sipas specifikimit teknik të detyrueshëm. Pretendimet e OE ankues gjatë kërkesës për rishqyrtim kanë qenë si më poshtë: Kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e kontratës, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit; Dëshmia 3: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmhohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Gjatë procedurës se rishqyrtimit OE ankues ka pas vetëm një pretendim i cili është i njëjtë me pretendimin e shqyrtuar me vendimin e OSHP 2024/030. Vendimi i OSHP-se: AK obligohet të bëjë vetëm ri-vlerësimin e atyre ofertave të cilat janë eliminuar për mos plotësim të vetëm këtij kriteri, duke përfshirë edhe ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. AK (komisioni i rivlerësimit) gjatë rivlerësimit ka konstatuar se OE ankues e plotëson kriterin e kërkesës 3 për mjete dhe stabilimente por që nuk i plotëson disa kriteret tjera të përshkruara ne sqarimin me lartë. Pas ankesës ne OSHP te datës 02.04.2024 OE ankues i ka ndryshuar pretendimet ankimore të cilat i ka paraqitur ne kërkesë për rishqyrtim. Si përfundim OE ankues nuk i ka pretendimet e njëjta me ato të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.”

Konstatimi i parë (I): “Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesat teknike & profesionale: Kërkesa 1: Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Dëshmia 1: Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e furnizimeve, min. 5 punëtor me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite), pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Eksperti shqyrtues

sqaron se pretendimi i OE ankues nuk ka qenë e përfshirë në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-se rrjedhimisht konsideroj se nuk është udhëheqë një procedurë paraprakë në pajtim me Rregulloren e Punës së OSHP-se Neni 13 pika 1 si dhe nenin 109 të LPP-se paragrafi 1: Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.”

Konstatimi i dytë (II): “Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me specifikimet teknike të detyrueshme sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues nuk ka qenë e përfshirë në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-së rrjedhimisht konsideroj se nuk është udhëheqë një procedurë paraprake në pajtim me Rregulloren e Punës së OSHP-se Neni 13 pika 1 si dhe nenin 109 të LPP-se paragrafi 1: Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa, OE Nuk Pajtohet lidhur me konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues, sepse pretendimet janë të njëjta sikurse në kërkesë për ri-shqyrtim. Pas kësaj përgjigje Paneli Shqyrtues bëri një verifikim në sistem të e-prokurimit dhe evidentohet qartë se pretendimet ankimore janë të njëjta, megjithatë edhe përmes email-it kërkoj nga ana e administratës të konstatohet një gjë e tillë, nëse është e vërtetë të kthehet mbrapa raporti i ekspertizës dhe të plotësohet konform kërkesave ligjore konkretisht nenit 113 dhe 114 të LPP. Eksperti shqyrtues e pranoj këtë gabim të cilin e ka bërë gjatë shkarkimit të dokumentacionit dhe menjëherë ka filluar ta plotësoj raportin e ekspertizës dhe me dt. 10.06.2024, e ka dorëzuar në OSHP, me konstatimet si në vijim:

Pretendimi 1.Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas dosjes së tenderit është kërkuar: Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues me ofertën ka dorëzuar listën prej dhjetë (10) punëtorëve si pjesë e kompanisë të lëshuar nga ATK. Pas verifikimit në webfaqen e ATK rezultoi se pesë (5) prej tyre u janë paguar kontributet në mënyrë të rregullt derisa pjesa tjetër nuk kanë qenë pjesë e kompanisë në kohën e ofertimit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se përkundër faktit se AK në vlerësim e ka shpallur të papërgjegjshëm OE ankues për shkak se “nuk janë nënshkruar punëtorët në atë listë” duke u thirrur në nenin 72 paragrafi 3 me arsyetimin se nuk mund të kërkohej i ka mohuar të drejtën OE ankues që të sqaroj ofertën e tij në përputhje me nenin 59.2 Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindro nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59.2 të LPP-se duke paragjykuar në përgjigjen e OE ankues në rast të sqarimeve kështuqë duke i mohuar OE

ankues te drejtën qe te trajtohet ne përputhje me nenin 7 te LPP-se dhe si rrjedhoje pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 2. Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me specifikimin teknik te detyrueshëm sipas dosjes se tenderit aneksit 1, Eksperti Shqyrtues sqaron se: Pas administrimit te provave, dosjes se tenderit, njoftimit për vendim te AK-se, raportit te vlerësimit, ofertës se OE ankues (certifikata dhe atesti i peletit 05.06.2023) eksperti shqyrtues vlerëson se me oferte OE ankues ka dorëzuar edhe certifikatën e atestit valide e cila përfshin dendësinë dhe mbetja e pluhurit. Ndërsa arsyeja se mungon ISO 17225-2 ne ambalazh nuk qëndron sepse mostra e dorëzuar me oferte e ka te shtypur edhe standardin.

Eksperti shqyrtues sqaron se mospërputhja e vetme është tek përbërja e peletit e cila është dorëzuar nga OE ankues ne 100% ahu qe është me cilësore se ajo që është kërkuar me dosje te tenderit Aneksi 1.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se përkundër faktit se është përgjegjësi ekskluzive e AK-se qe te vendos ne përcaktimin e nevojave qe duhet përmbushur sipas nenit 9 te LPP-se poashtu është edhe për tu siguruar qe vlerësimi te bëhet ne përputhje me nenin 24.2 si dhe nenin 1 paragrafi 1 te LPP-se. Sipas UOPP 001/2023 paragrafi 10.1 sqarimet (“specifikimit teknik”– AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara,

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se është e domosdoshme që për këtë lëndë të mbahet seancë dëgjimore Rregullores së Punës së OSHP-së dhe me dt. 18.06.2024, mbahet seanca ndëgjimore ku ishin prezentë përfaqësues të AK, përfaqësues të OE dhe eksperti shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e plotësuar ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i plotësuar i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99

lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas dosjes së tenderit është kërkuar e mbështet konstatimin e Ekspertit shqyrtues se OE ankues me ofertën ka dorëzuar listën prej dhjete (10) punëtorëve si pjese e kompanisë të lëshuar nga ATK. Pas verifikimit ne webfaqen e ATK rezulton se pese (5) prej tyre u janë paguar kontributet ne mënyrë te rregullt derisa pjesa tjetër nuk kane qene pjese e kompanisë ne kohen e ofertimit. Andaj, duke u nisur nga fakti se OE ankues i ka punëtor të tij dhe janë të deklaruar me ATK atëherë AK, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë ne përputhje me nenin 59.2 Autoriteti kontraktues, si dhe nënshkrimi i punëtorëve në listë të konsiderohet si devijim i vogël konform nenit 59.4 të LPP, pasi që është fakt i ditur se ankuesi i posedon këta punëtor, andaj këtë pretendim Paneli shqyrtues e kualifikon si pjesërisht të bazuar.

Por, ajo se çka nuk mundet me u marrë nga ana e AK dhe nuk e ka marrë si devijim të vogël, e që është në diskrecion të AK sipas nenit 59.4 të LPP, është arsyeja tjetër e eliminimit të këtij ankuesit i cili nuk ka ofertuar sipas specifikave teknike,ku është kërkuar në Dosje të Tenderit se përbërja e peletit duhet të jetë 70% dru Ahu dhe 30% dru pishë, ndërsa, ankuesi ka ofruar pelet me përmbajtje 100% dru ahu. Këtë e konstaton edhe eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës së tij **se mospërputhja e vetme është tek përbërja e peletit e cila është dorëzuar nga OE ankues ne 100% ahu**. Kjo mund të vërtetohet edhe nga ambalazhimi i thesit të peletit të ofruar si mostër nga OE ankues me rastin e ofertimit, ku AK në seancën e mbajtur i sjell si dëshmi fotot e bëra të mostrave (të ankuesit dhe të rekomanduarit).

Andaj, Panelin Shqyrtues konsideron e OE ankues nuk mund të jetë ofertë e përgjegjshme deri sa nuk oferton konform kërkesave të Dosjes së Tenderit, kjo është edhe kërkesë edhe e nenit 59 të LPP, gjegjësisht nenit 59.4 i cili citon: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"*.

Për më tepër edhe Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuse e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish vendimin e saj bazuar në gjetjet e ekspertit shqyrtues. Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të refuzojë raportin e ekspertit, duke ripërsëritur se AK e konsideron ofertën OE të rekomanduar si të përgjegjshme, ndërsa ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në

fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Rahovecit lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit për vitin 2023 2024" me nr. Të prokurimit: "623-23-13234-1-2-1".

Rrjedhimisht paneli shqyrtues duke marrë parasysh të gjitha veprimet e palëve në procedurë të shpjeguara në mënyrë konkrete dhe të hollësishme në raportin e plotësuar të ekspertizës Nr. 2024/0285, që ankesa të kualifikohet si pjesërisht e bazuar dhe ti jep të drejtën AK që të lenë në fuqi vendimin e saj, vendim ky që i paraprinë edhe një vendim tjetër me rezultat të njëjtë për fituesin, që do të thotë se janë dy vendime nga dy komisioneve të një pasnjëshme dhe këto komisione të cilat supozohen të jenë profesionale konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: *"Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"*, atëherë në kuptim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta zgjasë aktivitetin e prokurimit. Edhe më tutje dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasuri të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar dhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar *"Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj"*.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafet 1 dhe 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - Avni Murtezi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: